



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrasnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

RAPORT I VLERËSIMIT EX-POST

PËR

LIGJIN NR.05/L-134 PËR LEGALIZIMIN

DHE

DORËZIMIN E ARMËVE, MUNICIONIT DHE MJETEVE EKSPLOZIVE

Institucioni propozues	Departamenti Ligjor i Ministrisë së Punëve të Brendshme
Titulli i Raportit të Vlerësimit Ex-Post	Raport i Vlerësimit <i>Ex-Post</i> për Ligjin Nr.05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive
Personi kontaktues	Almenida BAJRAMI Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjeve, Mbështetjes Ligjore dhe Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit Departamenti Ligjor Ministria e Punëve të Brendshme
Grupi punues	<u>Anëtarët e Grupit Punues:</u> <ol style="list-style-type: none"> 1. Almenida Bajrami – Departamenti Ligjor /MPB – kryesuese; 2. Burim Kadriu – Departamenti për Siguri Publike/MPB – zëvendës kryesues; 3. Edon Azemi – Departamenti për Siguri Publike/MPB – anëtar; 4. Driton Ademi – Departamenti për Siguri Publike/MPB – anëtar; 5. Diellza Muja – Zyra Ligjore /ZKM – anëtare; 6. Zana Selimi – Departamenti Ligjor /MD – anëtare; 7. Ekrem Ademi – Ministria e Mbrojtjes – anëtar; 8. Arbnesht Ajvazi – Policia e Kosovës/MPB – anëtar; 9. Bahri Hyseni – Zyra e Kryeprokurorit – Prokuroria e Shtetit – anëtar; 10. Lutfi Raci – Departamenti i Balistikës, Agjencia e Kosovës për Forenzikë/MPB – anëtar; 11. Naim Hajdini – Departamenti Ligjor /MPB – anëtar. <u>Ekspertët:</u> <ol style="list-style-type: none"> 1. Alain Lapon – UNDP; 2. Mentor Canolli – UNDP; 3. Sali Berisha – ILECU.
Data:	19 dhjetor 2023

1 Raport i vlerësimit ex-post për Ligjin nr.05/1-134 për legalizimin dhe dorëzimin e armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive, i miratuar me Vendimi e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.23/180 dt.27.12.2023

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Çështja e armëve për herë të parë me ligj është rregulluar përmes Ligjit Nr. 03/L-143 për Armë, i cili në dispozita të caktuara kishte të rregulluar edhe çështjen e legalizimit dhe amnistisë së armëve.

Gjithsesi, një rregullim i tillë kishte vështirësi zbatimi në praktikë. Për shkak të nevojës dhe rëndësisë së çështjes, lidhur me legalizimin e armëve, u parapanë ndryshime kushtetuese.

Kuvendi i Republikës së Kosovës përmes Amendamentit 23 e plotësoj dhe ndryshoj nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës me tekstin si në vijim:

“Kuvendi jep amnisti me ligj përkatës, i cili duhet të miratohet me 2/3 e votave të gjithë deputetëve të Kuvendit”.

Kjo në kuptim të armëve nënkuptonte një falje të garantuar me ligj për të gjithë personat fizik dhe juridik që aplikojnë për legalizimin e armëve të zjarrit në pajtim me Ligjin për Armët ose dorëzimit vullnetarë të armëve të ndaluara të zjarrit dhe mjeteve tjera shpërthyesë gjatë një periudhe kohore specifike të përcaktuar dhe të shpallur që mund të jetë subjekt i ndjekjes penale për vepra të tilla penale sipas Kodit përkatës Penal të Republikës së Kosovës.

Në kuadër të një numri veprimesh për përmbushje të kësaj kërkesë kushtetuese, si dhe arritjes së qëllimit kryesor për legalizim të armëve të jashtëligjshme në Republikën e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme në vitin 2015 ka hartuar Koncept Dokumentin për Legalizimin e Armëve dhe Dorëzimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive, i cili u miratua nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Për më tepër, legalizimi i armëve dhe dorëzimi i armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe armëve eksplozive ndërli dhej gjithashtu edhe me prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe është i lidhur ngushtë me procesin e integritimit evropian, si dhe obligimeve tjera ndërkombëtare.

Koncept Dokumenti i hartuar parashihte hartimin e një Ligji për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive. Në këtë obligim, Ministria e Punëve të Brendshme hartoj ligjin i cili u miratua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2017.

Ligji Nr. 05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës¹ më datën 21 prill 2017 dhe sipas nenit 13 të tij, ka hyrë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive, Ministria e Punëve të Brendshme u caktua si organ kompetent për zbatim të obligimeve që dalin nga ky ligj.

Duke marrë parasysh se procesi i legalizimit dhe dorëzimit të armëve është proces i vazhdueshëm dhe tejet i rëndësishëm, është vlerësuar si e domosdoshme që të bëhet vlerësimi *Ex-post* i këtij ligji.

Qëllimi i kësaj iniciative është që të identifikohen sfidat në zbatimin e këtij ligji, me rëndësi të veçantë procedura e aplikimit për legalizim dhe dorëzim të armëve, roli i personit juridik, autoritetet, e në veçanti për të parë se cilët janë hapat që duhet ndërmarrë për të fuqizuar zbatimin e tij.

Më konkretisht, me këtë vlerësim, synohet të kuptohet nëse pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive, nga e cila kanë kaluar gati gjatë (6) vite, a kanë qenë në dispozicion burimet e mjaftueshme për të mbështetur zbatimin e këtij ligji, nëse institucionet apo mekanizmat përgjegjës për zbatimin e tij kanë vepruar në pajtim me përgjegjësitë e tyre dhe nëse i njëjti është në harmoni me kornizën tjetër ligjore.

Gjatë hartimit të këtij raporti të vlerësimit *Ex-post*, janë hasur vështirësi në sigurimin e të dhënave statistikore për rastet e referuara të legalizimit të armëve, gjë e cila ka ndikuar që raporti të mos jetë i plotë në mungesë të të dhënave konkrete.

Në këtë drejtim, Ministria e Punëve të Brendshme ka themeluar Grupin Punues² i cili është mandatar që të bëjë vlerësimin *Ex-Post* të Ligjit Nr. 05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive. Ky grup punues udhëhiqet nga Departamenti Ligjor dhe Departamenti për Siguri Publike i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe në të cilin bëjnë pjesë edhe përfaqësuesit e institucioneve të tjera.

Ky raport po ashtu nxjerr në pah jo-koherencën dhe kolizionin midis dispozitave ligjore të këtij ligji me dispozitat e ligjeve të tjera, si p.sh. Ligjin për Kundërvajtje, Ligjin për Procedurën e Përgjithshme, Kodin Penal të Kosovës, ku evidentohet nevoja për ndryshime dhe plotësime të ligjit për tu harmonizuar me dispozitat përkatëse të këtyre ligjeve, për të cilat detajet pasqyrohen në pikat më poshtë.

¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 13 / 21 prill 2017, e qasshme online < <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=14605>>

² Themeluar me Vendimin Nr. 704/2023 të datës 18.05.2023 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në këtë vlerësim, është zgjedhur metoda e “Vlerësimi i zbatimit dhe pajtueshmërisë” si një nga tri (3) llojet e vlerësimit *Ex-Post*, me qëllim që të vlerësohet në tërësi procesi i zbatimit Ligjit Nr. 05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive. Për më tepër ky vlerësim do të evidentojë nëse zbatimi po realizohet në mënyrën e duhur, si dhe me qëllim të identifikimit të faktorëve që kanë ndihmuar ose penguar zbatimin adekuat të tij.

Lidhur me fushëveprimin e vlerësimit, i njëjti mbulon ligjin në tërësi.

Në fund, Raporti rekomandon veprime korigjuese në lidhje me Ligjin Nr. 05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive. Më konkretisht, rekomandimet konsistojnë në hapat që duhet ndërmarrë për të adresuar sfidat dhe boshllëqet e identifikuar sa i takon zbatimin të tij, duke filluar nga nevoja që ligji të ndryshohet dhe plotësohet me qëllim të harmonizimit të tij me legjislacionin tjetër në fuqi.

I. HYRJE

A) Konteksti i vlerësimit

Gjatë procesit të monitorimit dhe analizës së zhvilluar gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, por edhe nga të dhënat e mëhershme vërehet se zbatimi i ligjit nga institucionet përgjegjëse është tejte sfidues, kryesisht për shkak të disa problemeve në ligj dhe mungesës së kapaciteteve humane.

Përzgjedhja e këtij ligji për t’iu bërë vlerësimin *Ex-Post* është bërë, ndër të tjerash, duke marrë parasysh rëndësinë e jashtëzakonshme që ka ky ligj në fushën e rendit dhe sigurisë publike.

Prandaj, nisur nga kjo si dhe bazuar në kërkesat e dala nga Departamenti për Siguri Publike në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, kjo e fundit është përcaktuar në vlerësimin *Ex-post* të Ligjit Nr. 05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive.

B) Qëllimi dhe fushëveprimi i vlerësimit

Qëllimi i këtij Raporti të Vlerësimit *Ex-Post* është të nxjerrë në pah sfidat kryesore në fushën e legalizimit, dorëzimit të armës dhe sfidat e organeve dhe institucioneve në aspektin ligjor, institucional dhe funksional, me theks të veçantë

në kryerjen e analizës sa i takon zbatimit dhe harmonizimit të këtij ligji me legjislacionin tjetër në fuqi.

Ky vlerësim, gjithashtu synon që të identifikojë boshllëqet dhe të propozoj rekomandimet përkatëse për një rishikim të kornizës ligjore dhe propozimet konkrete në kuptim ndryshimeve legjislative, duke përfshirë edhe përcaktimin e kompetencës së organeve përgjegjëse për shqiptimin e sanksioneve kundërvajtëse, si dhe aspektet organizative dhe funksionale.

Në këtë kuptim, kjo analizë, pra ky vlerësim *Ex-post* do të shërbejë si bazë për ndryshimet e ardhshme legjislative të ligjit.

Rrjedhimisht, vlerësimi *Ex-Post* i ligjit është konsideruar një instrument shumë i nevojshëm për të identifikuar nivelin e zbatimit, sfidat që janë hasur gjatë zbatimit, si dhe masat që duhet ndërmarrë me qëllim të fuqizimit të zbatimit të këtij ligji.

Vlerësimi i Ligjit Nr. 05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive bëhet për periudhën nga hyrja në fuqi e deri në muajin dhjetor 2023.

Ky vlerësim *Ex-post* në fushëveprim ka ligjin në tërësi.

Po ashtu, ky vlerësim analizon edhe nivelin e harmonizimit të Ligjit Nr. 05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive me legjislacionin tjetër në fuqi.

Palët e përfshira në mënyrë aktive në procesin e zbatimit të ligjit janë:

- Ministria e Punëve të Brendshme, konkretisht Agjencitë dhe/apo Departamentet e saj si në vijim:
 - Policia e Kosovës;
 - Departamenti për Siguri Publike.
 - Agjencia e Kosovës për Forenzikës;
 - Personi juridik i licencuar.

II. PËRSHKRIMI I LIGJIT QË DO TË VLERËSOHET DHE METODOLOGJIA E ZBATUAR

A) Përshkrimi i ligjit ose aktit nënligjor që do të vlerësohet

Ligji Nr. 05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive përcakton të drejtën për personat fizik dhe juridik për legalizim të armës apo dorëzimin vullnetar të armëve, municionit, si dhe mjeteve eksplozive që i kanë në posedim të paligjshëm gjatë afatit kohor për legalizim dhe dorëzim të përcaktuar sipas dispozitave të këtij ligji, me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt për të gjithë qytetarët.

Vlerësimi *Ex-post* është realizuar në tërësi të Ligjit Nr.05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive, pasi që është e rëndësishme të vlerësohet ndikimi i tij i përgjithshëm në ngritjen dhe zbatimin e masave të sigurisë publike gjatë procesit të legalizimit dhe procesit të dorëzimit në Kosovë. Për më tepër, ndërveprueshmëria mes neneve dhe varësia që kanë në zbatim nenet mes njëra tjetrës, e bën të pamundur që ky ligj të trajtohet vetëm në disa nene të caktuara.

Ligji Nr.05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive ka dhënë autorizim që me akte nënligjore të rregullohen më në detaje çështjet të cilat ndërlidhen me:

- Legalizimin e armëve;
- Dorëzimi i armëve, municioneve dhe mjeteve eksplozive; dhe
- Qendrën Koordinuese Shtetërore.

Që nga hyrja në fuqi, në zbatim të ligjit Ministria e Punëve të Brendshme ka miratuar vetëm aktin nënligjor që buron nga neni 4 dhe 5 i Ligjit Nr.05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive, më konkretisht ka miratuar vetëm Udhëzimin Administrativ (MPB) Nr. 09/2018 për Legalizimin e Armëve³.

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim që të përcaktojë afatet dhe modalitetet operative, librezën, kërkesën dhe pëlqimin për legalizimin e armës dhe procedurat që duhet të ndiqen nga personi juridik i licencuar gjatë afatit kohor për legalizim të përcaktuar, me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt për të gjithë qytetarët.

Gjithsesi, aktet nënligjore që burojnë nga neni 8 (Dorëzimi i armëve, municioneve dhe mjeteve eksplozive) dhe nga neni 10 (Qendra Koordinuese Shtetërore) nuk janë hartuar asnjëherë dhe rrjedhimisht këto dy çështje, pra dorëzimi dhe funksionimi i Qendrës Koordinuese Shtetërore nuk janë rregulluar. Këto çështje janë të ndërlidhura ngushtë me njëra tjetrën, sepse meqenëse çështja e dorëzimit të armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive nuk ka filluar të zbatohet asnjëherë,

³ Publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 08.11.2023, i qasshëm online <<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18097>>

atëherë edhe themelimi i Qendrës Koordinuese Shtetërore dhe rregullimi i funksionimit të saj, nuk është bërë asnjëherë. Gjatë analizës së grupit punues në hartim të këtij vlerësimi *ex-post* është arritur në përfundim se për shkak të vështirësive të hasura në zbatim nga njësitë përgjegjëse, nuk është iniciuar asnjëherë hartimi i këtyre akteve nënligjore.

Sa i përket procedurave, Ministria e Punëve të Brendshme gjithashtu ka marrë edhe tre (3) Vendime. Vendimi 536/2018⁴ që buron nga neni 4 i Ligjit Nr.05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive shpall dhe përcakton afatin kohor për legalizim të armëve, i cili është nga data 17 dhjetor 2018 deri më 17 qershor 2019. Në vazhdë të këtij Vendimi, gjithashtu është marrë edhe Vendimi 15/107⁵ që shtyn afatin kohor për legalizim të armëve deri më 17 shtator 2019.

Me datë 12.08.2020 Ministri i Punëve të Brendshme përmes Vendimit Nr. 790/2020 vendos se të gjithë personat fizik dhe juridik që i kanë dorëzuar armët për legalizim në kompani private për riparim të armëve, të njëjtat mund t'i tërheqin dhe t'i ruajnë në shtëpitë e tyre.

B) Zingjiri i rezultateve

Duke marrë parasysh fushëveprimin dhe llojin e këtij vlerësimi *Ex-post*, grupi punues ka ardhur në përfundim se kjo pjesë nuk aplikohet për këtë vlerësim.

C) Metoda e vlerësimit *Ex-post*

Ministria e Punëve të Brendshme në zbatim të Udhërrëfyesit për Vlerësimin *Ex-post* të Legjislacionit në Republikën e Kosovës, ka themeluar grupin punues me datë 18.05.2023, i cili është mandatuar për të bërë vlerësimin *Ex-post* të Ligjit Nr.05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive. Ky grup punues udhëhiqet nga Departamenti Ligjor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me Departamentin për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si dhe pjesëmarrës të institucioneve të tjera kompetente në fushën e legalizimit të armëve të cilët janë të involvuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi në zbatimin e ligjit siç janë Zyra e Kryeministrit, Policia e Kosovës, Ministria e Mbrojtjes, Prokuroria e Shtetit dhe Agjencia e Kosovës për Forenzikë.

Metodologjia në përgatitjen e Raportit të vlerësimit *Ex-Post* të Ligjit Nr.05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive

⁴ Vendimi Nr. 536/2018 është miratuar më datë 23.11.2018 nga ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

⁵ Vendimi Nr. 15/107 është miratuar me datë 18.06.2019 nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

përfshinë përdorimin e metodës cilësore dhe metodës së analizës, pasi që ajo ka synim mbledhjen e të dhënave mbi funksionimin aktual strukturor për njësitë apo zyrtarët përkatës për të koordinuar dhe raportuar zbatimin e këtij ligji, kryerjen e analizës për mënyrën e koordinimit, raportimit dhe bashkëpunimit me Departamentin për Siguri Publike.

Të dhënat janë mbledhur disa burime kryesore dhe atë si në vijim:

- a. Legjislacioni në fuqi në fushën e legalizimit dhe dorëzimit vullnetar të armëve dhe municionit;
- b. Dokumente të tjera relevante nga institucionet e fushës së legalizimit dhe dorëzimit vullnetar të armëve dhe municionit;
- c. Takimet me zyrtarë dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e Ligjit Nr.05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive me qëllim të mbledhjes së të dhënave për sa i takon nivelit të zbatimit, si dhe sfidave me të cilat ballafaqohen këto institucione.

Sa i përket burimeve të legjislacionit, është analizuar legjislacioni në tërësi, duke filluar nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji përkatës për Armë, Ligji përkatës për Eksplozivë, Ligji për Legalizim dhe Dorëzim, si dhe aktet e tjera nënligjore dhe Vendimet përkatëse të nxjerra në zbatim të Ligjit Nr.05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës⁶

Kushtetuta e Republikës së Kosovës me amendamentin 23 në Nenin 65, paragrafi 15 përcakton se amnistia mund të jepet vetëm përmes ligjit përkatës. Pra, për trajtimin e këtij problemi duhet të nxirret ligj përkatës.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës⁷

Çështja që ndërlidhet me armë, municione dhe mjetet plasëse trajtohet në kapitullin XXIX – Veprat Penale të Armëve. Më konkretisht neni 364 deri në nenin 369, rregullojnë çështjen e veprave penale për armë të cilat ndërlidhen dhe me problemin e legalizimit dhe dorëzimin e armëve.

⁶ Publikuar në Gazetën Zyrtare e Republikës së Kosovës me datë 09.04.2023, e qasshme online <<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>>

⁷ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 02 / 14 janar 2019, e qasshme online <<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>>

Nr. 05/L-022 për Armë⁸

Në nenet 34 dhe 35 të Ligjit Nr. 05/L-022 për Armë përcaktohet legalizimi dhe dorëzimi vullnetar i armëve ku theksohet se legalizimi dhe dorëzimi i armëve rregullohet me ligj të veçantë.

Ligji Nr. 04/L-022 për Përdorim Civil të Eksplozivëve⁹

Ligji Nr. 04/L-022 për Përdorim Civil të Eksplozivëve përcakton kushtet dhe kriteret e prodhimit, tregtimit, importit, eksportit, transitit, transferimit, deponimit, përdorimit dhe asgjësimit të eksplozivëve apo fishekzjarrëve, si dhe kriteret për mbikëqyrjen dhe aplikimin e këtij ligji me qëllim të mbrojtjes së njerëzve, pasurisë dhe mjedisit. Një ndër elementet kryesore të kësaj mbikëqyrje është sigurisht edhe përdorimi i ligjshëm i mjeteve dhe lëndëve eksplozive.

Mbajtja e takimeve me akterët relevant

Në kuadër të takimeve me institucionet relevante përgjatë kohës janë mbajtur disa takime të grupit punues, ku janë identifikuar dhe diskutuar sfidat në zbatim të Ligjit Nr.05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive. Rezultatet e këtyre diskutimeve, duke përfshirë këndvështrimet e këtyre institucioneve, masat që kanë ndërmarrë në zbatimin e tij, sfidat që kanë pasur, kapacitetet që kanë në dispozicion për të siguruar kryerjen e përgjegjësiwe ligjore, kanë qenë pjesë e diskutimeve të grupit punues.

Gjatë këtij procesi, Departamenti për Siguri Publike në bashkëpunim me Departamentin Ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme kanë qenë përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave të nevojshme për realizimin e këtij vlerësimi të detajuar. Ky raport bazohet në këto të dhëna dhe analiza zyrtare, të cilat janë ndarë dhe diskutuar me grupin punues. Të dhënat mbulojnë periudhën prej hyrjes në fuqi të ligjit në prill 2017, deri në dhjetor 2023.

Bazuar në këtë, Ministria ka ndërmarrë të gjitha veprimet dhe ka bërë vlerësimin e gjithë procesit të zbatimit ligjit.

Sigurisht, sfiduese për analizë ka qenë mungesa e kompletimit të kornizës ligjore, konkretisht e akteve nënligjore që autorizohen nga Ligji Nr.05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive.

⁸ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 25 / 19 gusht 2015, e qasshme online <<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11018>>

⁹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9 / 22 gusht 2011, e qasshme online <<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2751>>

III. REZULTATET E VLERËSIMIT

A) Zbatueshmëria e ligjit

a. Informacione të përgjithshme

Nga procesi i vlerësimit *Ex-post*, konkretisht nga takimet e realizuara të grupit punues me institucionet kompetente, rezulton se zbatimi i Ligjit Nr.05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive është përcjellë me disa sfida, ndër të cilat kryesore kanë qenë formulimi jo i gjerë i dispozitave ligjore, mungesa e harmonizimit me Ligjin për Procedurën Administrative, si dhe mungesa e burimeve njerëzore për zbatimin e këtij ligji.

Mungesa e harmonizimit me ligjet e tjera në fuqi

Ligji referuar çështjeve që mbulon, është i harmonizuar me Ligjin përkatës për Armë. Procedurat e përcaktuara në këtë ligj, referojnë tek Ligji përkatës për Armë dhe të njëjtat nuk kanë qenë deri vonë të harmonizuara me Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Gjithsesi, pas harmonizimit të Ligjit për Armë me LPPA, në pjesë të madhe të tij, Ligjit Nr.05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive vlerësohet se është në harmoni. Për pjesët të cilat nuk janë harmonizuar, janë të paraqitura në pjesën “Harmonizimi” të këtij raporti të vlerësimit *Ex-post*.

Mungesa e resurseve të mjaftueshme njerëzore

Nevoja e rritjes së kapaciteteve njerëzore, konkretisht e zyrtarëve të cilët merren ekskluzivisht me zbatimin e këtij ligji është i domosdoshëm. Më saktësisht, personat që kanë të bëjnë me mostra apo teste të armëve dhe identifikimin e armëve duhet që patjetër të kenë njohuri të mjaftueshme për armët dhe municionet në mënyrë që të mos ketë probleme edhe në të ardhmen. Shpeshherë rekrutimi dhe mbajtja e këtyre personave paraqitet si sfiduese, andaj grupi punues e ka vlerësuar këtë si mungesë.

Mungesa e resurseve të mjaftueshme në mbikëqyrje të zbatimit të këtij ligji

Njësia brenda së cilës është deleguar kompetenca për mbikëqyrje të zbatimit të këtij ligji, nuk ka arrit t'i përmbushë kërkesat ligjore, për shkak të mungesës së strukturës adekuate ligjore për këtë.

Kompetenca të qarta ligjore lidhur me mandatet mbikëqyrëse janë të nevojshme me qëllim të avancimit dhe zbatimit adekuat të ligjit.

Mospërshtatja e kornizës ligjore me situatën në vend

Grupi Punues ka vlerësuar që Ligji Nr.05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive nuk ka arritur që në mënyrë efektive të adresojë situatën e legalizimit të armëve, sepse procedurat kanë qenë tejet të ngarkuara për palët e përfshira, pra për qytetarët por edhe për institucionet shtetërore në zbatim të këtij ligji, përfshirë edhe personat e tjerë juridik. Një situatë e tillë ka rezultuar me pasojë në dëm të qytetarit, sepse nuk janë ndërmarrë veprime në realizim të kësaj të drejte.

Sipas këtij ligji, procedura për legalizim të armëve ka vendosur si akter kryesor personin fizik, gjë e cila sipas të dhënave zyrtare rezulton se nuk ka funksionuar. Pra, personi fizik gjatë periudhës së legalizimit, duhet të paraqitet në stacionin policor më të afërt në vendbanimin apo vendqëndrimin e tij dhe të deklaroj posedimin e armës të cilën nuk e ka regjistruar më parë, me ç ‘rast të njëjtit pajisen me librezë dhe kërkesë për legalizimin e armës, me kusht që plotëson kriteret e përcaktuara në ligj. Gjithsesi, pas marrjes së librezës, i njëjti është i obliguar që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh ta dërgoj armën tek personi juridik i licencuar. Personi juridik i licencuar sipas ligjit, obligohet ta ruaj armën dhe është përgjegjës për të verifikuar që arma nuk përbën rrezik për sigurinë publike, t’i bëj qitjen testuese dhe të vërtetoj nëse arma është shënjuar sipas nenit 56 të Ligjit për Armë.

Sa për ilustrim, nga statistikat zyrtare të pranuar nga Departamenti për Siguri Publike tregojnë se nga hyrja në fuqi e këtij ligji, pra nga viti 2017 janë bërë rreth dymijë (2000) kërkesa nga qytetarët për legalizimin e armëve dhe asnjë nga këto kërkesa nuk është finalizuar.

Në këtë kuptim, sfiduese del të jetë edhe përfshirja e personit juridik të licencuar i cili është personi juridik i licencuar për tregtimin, riparimin, çaktivizimin dhe prodhimin e armëve sipas Ligjit për Armë, të cilët në këtë ligj kanë qenë të mandatuar që të ruajnë armën dhe është përgjegjës për të verifikuar që arma nuk përbën rrezik për sigurinë publike, t’i bëjë qitjen testuese dhe të vërtetojë nëse arma është shënjuar.

Grupi Punues ka vlerësuar se personat juridik të licencuar nuk kanë gëzuar kapacitetet për të bërë një gjë të tillë.

Sa për ilustrim, Agjencia e Kosovës për Forenzikë gjegjësisht Divizioni i Balistikës, i cili ka qenë pjesëmarrës në procesin e pranimit dhe futjes së mostrave standard të qitjeve të armëve në sistemin “IBIS” dhe krahasimin e tyre me rastet e panjohura, të cilat mostra i kanë sjellë personat juridik të licencuar përmes Departamentit për Siguri Publike.

Nga ky proces Agjencia e Kosovës për Forenzikë ka theksuar se ka hasur në shumë parregullsi që personat juridik të licencuar, kanë bërë me rastin e

identifikimit të armëve, dhe përgatitjes së mostrave (gëzhjojave dhe plumbave), pra nuk kanë qenë në gjendje të identifikojnë:

- a) modelin, kalibrin dhe prodhuesin e armës;
- b) kriteri i shënimit të mostrave të sjella në shumë raste nuk është përfill, (gëzhojat dhe plumbat) nuk kanë qenë të shënuara apo identifikuar me armën përkatëse, ashtu siç është kërkuar;
- c) për shkak se municioni i përdorur në qitjet testuese ka qenë jo i mirë, me rastin e shkrepjes nuk janë prodhuar shenjat apo karakteristikat e armës në qitjet apo testet balistike në gëzhoja apo plumba;
- d) gjurmueshmëria në shumë raste ka qenë e nivelit të dobët për shkak se janë përdorur municion jo i mirë; dhe
- e) personat që kanë përgatit mostrat dhe informatat lidhur me përcaktimin se për çfarë arme bëhet fjalë nuk kanë poseduar njohuri të mjaftueshme për identifikimin e armëve që i kanë procesuar.

Të gjitha pikat e lartpërmendura janë kritere bazë për përgatitje të mostrave, identifikim dhe gjurmim të armëve, prandaj edhe në të ardhmen personat që i përgatisin këto mostra apo teste të armëve dhe identifikimin e armëve duhet që patjetër të kenë njohuri të mjaftueshme për armët dhe municionet në mënyrë që të mos ketë probleme edhe në të ardhmen.

Për shkak se procesi nuk ka arrit të finalizohet, ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme përmes Vendimit me Nr. 790/2020, të datës 12.08.2020, ka vendosur se:

“1. Të gjithë personat fizik dhe juridik që i kanë dorëzuar armët për legalizim në kompanitë private për riparimin e armëve, mund t’i tërheqin armët dhe t’i ruajnë në shtëpitë e tyre deri në një vendim tjetër ose procedurave të ngritura nga Departamenti për Siguri Publike”.

Gjithashtu, sfidë mbetet çështja se procesi i dorëzimit vullnetar nuk ka filluar asnjëherë.

b. Rëndësia

Në Republikën e Kosovës ende ka në posedim armë, municion dhe mjete eksplozive të jashtëligjshme. Prania e vazhdueshme e armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive të jashtëligjshme shërben në mënyrë të pashmangshme si faktor destabilizues në Republikën e Kosovës. Në duart e gabuara, ato kanë

potencial destabilizues dhe efektet e tyre negative mund të shumëfishohen. Si të tilla, ato paraqesin një rrezik të vazhduar për komunitetet, shoqëritë dhe institucionet. Policia e Kosovës në 20 vitet e fundit konfiskon rreth 1500 brenda vitit.

Legalizimi i armëve, municionit dhe mjete eksplozive të jashtëligjshme është një nga masat e kontrollit dhe ndër veprimtaritë më komplekse duke qenë se ai kërkon një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet disa institucioneve, si edhe të fitohet besimi i komunitetit.

Legalizimi i armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive të jashtëligjshme janë gjithashtu edhe qëllime të përcaktuara dhe marra përsipër në udhërrëfyesin e municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor brenda vitit 2024, përkatësisht objektivi 5 i cili saktëson se:

Brenda vitit 2024, të ulet mjaftueshëm numri i përlllogaritur i armëve të zjarrit që mbahen në mënyrë të paligjshme në Ballkanin Perëndimor”.

Ndërsa tek synimet e përgjithshme të këtij Udhërrëfyesi përcaktohet se duhet të “garantohet vendosja e masave ligjore që lejojnë legalizimin dhe dorëzimin vullnetar të armëve”.

Po ashtu është indikator i 11-të përcaktohet se ky indikator për Republikën e Kosovës do të vlerësohet nga numri i armëve, municioneve dhe eksplozivëve të dorëzuar vullnetarisht, si edhe i armëve të zjarrit të legalizuara ose të çaktivizuara.

Nga procesi i këtij vlerësimi *Ex-post* rezulton se ky ligj është tejet i rëndësishëm për të siguruar kuadrin e nevojshëm procedural për legalizim dhe dorëzim të armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive, mirëpo në disa raste mungon qartësia e plotë ligjore, si qartësia lidhur me kompetencën e mekanizmave në zbatim të ligjit. Rrjedhimisht, disa nga dispozitat duhet të ndryshohen dhe plotësohen, kryesisht me qëllim të harmonizimit.

c. Harmonizimi

Harmonizimi me standardet ndërkombëtare

Ndonëse sa i përket legalizimit të armëve nuk ka standard të unifikuar ndërkombëtar, por procedura pas legalizimit është e përcaktuar në Ligjin përkatës për Armë, i cili është në harmoni me *acqui* të BE-së.

Koherenca e brendshme

Ligji Nr.05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive nuk ka kundërthënie mes dispozitave.

Koherenca e jashtme

Rezultatet e vlerësimit tregojnë së gjatë hartimit të ligjit, i njëjti nuk ishte harmonizuar me disa ligje, më konkretisht me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Gjithsesi, për shkak të ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit Nr. 05/L-022 për Armë nga Ligji Nr. 08/L-176 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përmbajnë Procedura të Veçanta Administrative dhe Harmonizimin e Tyre me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative është bërë harmonizimi i afateve për ankesë, ku pas këtij ndryshimi pala e pakënaqur kundër vendimit ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e njoftimit me vendimin në pajtim me Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Mungesa e harmonizimit me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative¹⁰

Ndonëse i harmonizuar me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative sa i përket afateve të ankesës, ligji nuk është i harmonizuar sa i përket çështjes së barrës së provës. Sipas dispozitave të Ligjit Nr.05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive, është vet pala ajo që duhet të dorëzojë dokumentet që kërkohen sipas ligjit dhe udhëzimit administrativ në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa sipas përcaktimeve dhe kërkesave që burojnë nga Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, verifikimin dhe konstatimin e plotësimit të kriterëve të përcaktuara në ligj e bën vet organi i cili vet i siguron të dhënat, dokumentet ose informatat nga organet e tjera publike.

Efikasiteti

Duke pasur parasysh fushëveprimin dhe llojin e këtij vlerësimi *Ex-post*, grupi punues ka ardhur në përfundim se kjo pjesë nuk aplikohet për këtë vlerësim.

Përshtatshmëria

¹⁰ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20 / 21 qershor 2016, e qasshme online <<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>>

Në përgjithësi, ligji mund të konsiderohet ende relevant në fushën e legalizimit dhe dorëzimit të armëve. Megjithatë, me qëllim që legalizimi dhe dorëzimi i armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive të jetë sa më efikas, kërkohet një proces i rishikimit të këtij ligji.

Grupi punues ka vlerësuar se synimi kryesor i këtij vlerësimi *Ex-post* është gjetja e një mënyre efikase, të zbatueshme dhe me kosto efektive për reduktimin e posedimit të paligjshëm të armëve, municionit dhe armëve eksplozive në Kosovë me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt për të gjithë qytetarët.

Përveç kësaj, grupi punues ka vlerësuar se ky ligj nuk ka qenë mjaftueshëm efikas në adresim të çështjeve të cilat i mbulon, dhe se ka nevojë për harmonizim me ligjet e tjera relevante, andaj edhe duhet të ndryshohet.

IV. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

A) PËRFUNDIME

Analiza *Ex-post* e Ligjit Nr.05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive ka identifikuar ndikimin e shumanshëm të këtij ligji në sigurinë publike.

Ndërkohë që përgjatë zbatimit të tij kishte kontroll të përmirësuar mbi posedimin e ligjshëm të armëve të zjarrit, sfidat në lidhje me zbatimin e dorëzimit të armëve të paligjshme dhe adresimin e aktiviteteve të tregut të zi mbetën të përhapura. Ndikimi më i gjerë social dhe ekonomik identifikoj një ndërveprim. Si përfundim, analiza *Ex-post* pasqyron një peizazh të përzier të rezultateve, që kërkon vlerësim të vazhdueshëm dhe rregullime të mundshme të legjislacionit. Strategjitë gjithëpërfshirëse dhe adaptive janë të domosdoshme për të vendosur një ekuilibër midis sigurisë publike dhe të drejtave individuale në kontekstin e ligjeve të legalizimit të armëve dhe dorëzimit.

Gjendja aktuale e rregullimit të fushës së armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive dhe eliminimit të zbrazëtive juridike dhe të kolizionit ligjor ka vend për përmirësime të mëdha. Bazuar në të gjeturat e ofruara më lartë, Ligji Nr.05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive është në harmoni me standardet dhe praktikat më të mira. Megjithatë vlerësohet se ende ka hapësirë për harmonizimin e tij me ligjet e tjera në fuqi.

Grupi punues ka vlerësuar se Ligji Nr.05/L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive kategorizohet nga mangësitë si në vijim:

- Zbatim jo i plotë i ligjit;

- Harmonizim i ligjit me Ligjin për Procedurën Administrative;
- Mungesa e burimeve njerëzore.

B) REKOMANDIME

Rekomandimet në vijim janë rezultat i analizave të cilat gjatë zbatimit të ligjit në praktikë të prezantuar sipas konstatimeve në këtë raport vlerësimi, e që do të nënkuptonin në ndryshimet ligjore dhe atë si në vijim:

- Për qytetarin do të mjaftonte vullneti për dorëzimin e armës dhe nxjerrja e dokumenteve personale, kurse çështjet e verifikimit të shënjjimit, qitjet testuese dhe shënjjimin me rastin e legalizimit duhet t'i kryente shteti.
- Gjithashtu edhe ruajtjen e armës e cila është në proces të legalizimit, deri në përfundim të procedurave duhet ta bënte shteti.
- Gjatë hartimit të ligjit të ri për legalizim dhe dorëzim të armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive, duhet të rishikohet mandati dhe nevoja e përfshirjes së personit juridik të licencuar;
- Gjatë hartimit të ligjit të ri për legalizim dhe dorëzim të armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive, barra kryesore e këtij procesi duhet bartin institucionet;
- Në zbatim të projektit dhe objektivit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zvogëlim të barrës administrative, por edhe për shkak të interesit që ka shteti në kryerjen me sukses të këtij procesi, procedurat duhet të lehtësohen;
- Gjatë hartimit të ligjit të ri për legalizim dhe dorëzim të armëve, obligimi për ruajtjen e armës deri në përfundim të procedurave, duhet të bartet nga personi juridik i licencuar tek njësitë relevante në kuadër të institucioneve shtetërore.

Grupi punues në bazë të vlerësimit të bërë dhe rekomandimeve të nxjerra nga ky vlerësim, propozon hartimin e Ligjit të ri që do të trajtojë fushën e Legalizimit dhe Dorëzimit të Armëve, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive dhe akteve nënligjore të cilat janë nxjerrë për zbatim të ligjit.